



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES KONSTITUIVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 26 DHJETOR 2019**

**SA KONSTITUIVNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 26. DECEMBRA 2019. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2019**

Rendi i ditës

1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve,
2. Dhënia e betimit të deputetëve,
3. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit.

Dnevni red

1. Formiranje ad hoc komisije za verifikaciju kvoruma i mandata poslanika,
2. Polaganje zakletve poslanika,
3. Izbor Predsednika Skupštine i potpredsednika Skupštine.

Mbledhjen konstituive e drejtoi deputeti i Kuvendit, z. Jahja Kokaj.

KRESUESI: Përshëndetje!

Unë jam Jahja Koka, kurse zonjusha afër është Fjolla Ujkani. Karakterizohemi me numrat moshorë 71 dhe 22, të cilët në bazë të nenit 9, paragrafit të parë të Rregullores së Kuvendit të Kosovës na bëjnë të mundur që të jemi sot para jush dhe të udhëheqim me mbledhjen konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ç'është e vërteta, unë jam profesor universitar i laserëve dhe astrofizikës deri në këtë moment, por që e kam fatin që sot bashkërisht të gjendem para jush, me një detyrë shumë të rëndësishme kombëtare.

Më lejoni që të procedoj me përshëndetjet për personalitetet e caktuara. Më lejoni që t'i përshëndes ambasadorët dhe përfaqësuesit zyrtarë diplomatikë të vendeve mike që janë në Kosovë dhe janë të pranishëm.

Përshëndes të gjithë kolegët deputetë, të cilët shpresoj që tani së bashku, në mënyrë sa më koherente dhe të fuqishme të punojmë dhe të bëjmë ndryshimin e shumëpritur epokal gjatë lirinë 20-vjeçare të Kosovës.

Përshëndes në radhë qytetarët që na shikojnë, ata që votuan dhe mundësuan konstituimin e këtij Kuvendi. Përshëndes të gjithë të ftuarit e pranishëm. Përshëndes gazetarët dhe të gjithë ata që në mënyrë dashamirëse marrin pjesë në këtë mbledhje dhe mundësojnë që në mënyrë të frytshme ta realizojmë konstituimin e Parlamentit të shtatë të Republikës së Kosovës.

Më lejoni tani që, sipas nenit 9, paragrafit 3 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ta hap mbledhjen konstituive të Legjislaturës së Shtatë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ta propozoj këtë rend dite:

1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandateve të Deputetëve,
2. Bëtimi i deputetëve,
3. Zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me shpresë që pajtoheni me rendin e ditës, më lejoni që të kaloj në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandateve të Deputetëve

Zonja dhe zotërinj,

Ju njoftoj që deri në zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit nuk zhvillohet kurrfarë debati sipas rregullave konvencionale të rregullativave të Kuvendit.

Sipas nenit 9, paragrafi 8 i Rregullores së Kuvendit, partitë politike të përfaqësuara në Kuvend e caktojnë nga një deputet për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve. Është me rëndësi të theksohet që këta kanë për detyrë që të shqyrtojnë në dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve të mbajtura më 6 tetor të vitit 2019 për certifikimin e rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe pastaj Kuvendit t'ia paraqesin raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve dhe të verifikojnë kuorumin për seancën konstituive të Legjislaturës së Shtatë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sipas procedurës, para se të ftoj partinë e parë që të propozoj kandidatin e tyre, theksojmë që sipas rregullativës së Kuvendit, kryesuesi i Komisionit do të jetë nga subjekti politik që ka fituar më tepër vota, përkatësisht deputetë me numrin më të madh.

Në vijim, e ftoj Lëvizjen Vetëvendosje që ta propozoj kandidatin e vet për formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandateve të Deputetëve. Ju lutem, propozoni cili është përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje.

GLAUK KONJUFCA: Përshëndetje të gjithëve!

Përshëndetje mysafirëve!

Juve kolegë deputetë që ju kam këtu përballë.

Lëvizja Vetëvendosje për këtë komision e propozon zonjën Albulena Haxhiu. Faleminderit!

KRYESUESI: E falënderoj përfaqësuesin e Lëvizjes Vetëvendosje, i cili e propozon Albulena Haxhiun për anëtare të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandateve të Deputetëve.

E ftoj Lidhjen Demokratike të Kosovës që ta propozojë kandidatin e tyre.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit kryesuesi i seancës!

Më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve. Nga grupi ynë parlamentar në këtë komision do të jetë deputeti Armend Zemaj. Faleminderit!

KRYESUESI: E falënderoj përfaqësuesin e Lidhjes Demokratike për propozimin e Armend Zemajt për anëtar të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandateve të Deputetëve.

E ftoj Partinë Demokratike të Kosovës që ta propozojë kandidatin e tyre për anëtar të Komisionit Verifikues.

BEDRI HAMZA: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e propozon Ganimete Musliun për anëtare të Komisionit.

KRYESUESI: Pra, konstatojmë që e propozuara e Partisë Demokratike të Kosovës është Ganimete Musliu dhe e falënderojmë Partinë Demokratike të Kosovës për propozimin.

E ftoj Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partinë Socialdemokrate, koalicionin “100% Kosovë” që ta propozojë kandidatin e tyre për anëtar të Komisionit Verifikues.

DAUT HARADINAJ: Qind për qind, faleminderit kryesues!
Urime mandatet!
Përshëndetje për të gjithë!
Aleanca e propozon deputetin Rasim Selmanaj.

KRYESUESI: E falënderoj zotërinë përfaqësues të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për propozimin e Rasim Selmanajt për anëtar të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandateve të Deputetëve.

E ftoj Listën Serbe që ta propozojë kandidatin e tyre për Komisionin Verifikues.

IGOR SIMIĆ: Hvala predsedavajući!
Pozdravam sve prisutne, i u ime Srpske liste biće Slavko Simić. Hvala!

KRYESUESI: E falënderoj Listën serbe që e propozoi Slavko Simiq për anëtar të Komisionit Verifikues.

E ftoj Nismën Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë që ta propozojë kandidatin e tyre për Komisionin Verifikues.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!
Urime të gjithëve!
Ne si Nismë e propozojmë Albulena Balaj-Halimin që të jetë në Komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Pra, zonja Albulena Balaj-Halimi është e propozuara nga Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë për Komisionin Verifikues.

E ftoj Koalicionin Vakut që ta propozojë anëtarin për Komisionin Verifikues.

RASIM DEMIRI: Pozdrav za sve, čestitam svima novi mandat!
Izpred koalicije Vakut predlažem samoga sebe, to jest Rasim Demiri.

KRYESUESI: Konstatohet që zoti Rasim Demiri është i propozuari nga Koalicioni Vakut për Komisionin Verifikues.

E ftoj Partinë Demokratike Turke - Kosova Demokratik Turk Partisi që ta propozojë kandidatin e tyre për Komisionin Verifikues.

FIKRIM DAMKA: Ju uroj mandatin e ri!
Herkesin yeni gorevini tebrik ediyorum. Kosova Demokratik Turk Partisinden onerim Fidan Brina Jilta.

KRYESUESI: Zonja Fidan Brina Jilta është e propozuara e Partisë Demokratike Turke të Kosovës - Kosova Demokratik Turk Partisi.

E ftoj Partinë Liberale Egjiptiane që ta propozojë kandidatin e tyre për Komisionin Verifikues.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Më lejoni që t'i uroj të gjithë deputetët për mandatin e ri.
Meqenëse jam i vetmi deputet nga Partia Liberale Egjiptiane, atëherë unë do të jem anëtar i Komisionit për Verifikim të Mandateve. Suksese!

KRYESUESI: Konstatohet që Veton Berisha është i propozuari nga Partia Liberale Egjiptiane për Komisionin Verifikues.

E ftoj Partinë e Re Demokratike që ta propozojë anëtarin e tyre për Komisionin Verifikues.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvalujem se predsedavajući!
Svim kolegama zelim čestitati novi mandat!
U ime Nove Demokratske Stranke predlažem Emiliju Redžepi.

KRYESUESI: Pra, zonja Emilija Rexhepi është e propozuara nga Partia e Re Demokratike.

Në vijim ftoj Partinë e Ashkalinjve për Integrim që ta propozojë kandidatin e tyre për Komisionin Verifikues.

ETEM ARIFI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Urime për mandatin e ri kolegëve dhe kolegeve deputetë!

Nga Partia e Ashkalinjve për Integrim e propozoj vetveten, Etem Arifi.

KRYESUESI: Pra, konstatoj që zoti Etem Arifi është i propozuari nga Partia e Ashkalinjve për Integrim për anëtar i Komisionit verifikues.

Në vijim, e ftoj Iniciativën e Re Demokratike të Kosovës që ta propozojë kandidatin e tyre për Komisionin Verifikues.

ELBERT KRASNIQI: Të nderuar kolegë deputetë,

IRDK-ja e ka vetëm një deputet. Kështu që vetëpropozohem, Elbert Krasniqi.

KRYESUESI: Më falni kolegë deputetë,

Unë vij nga Akademia, nuk kam rast që të interferojmë. Përderisa flasin të tjerët, të tjerët mbajnë qetësi. Faleminderit për kujdesin!

Konstatoj që Elbert Krasniqi është i propozuari nga Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës.

Partia e Bashkuar Gorane është në radhë për ta propozuar kandidatin e tyre për Komisionin Verifikues.

ADEM HODŽA: Hvala predsedavajući!

Da iskoristim priliku da čestitam svim kolegama koji su dobili mandat i svih koji su ovde u sali. Ispred Jedinstvene goranske partije s obzirom da jedan predlažem Adema Hodžu. Hvala!

KRYESUESI: Pra, konstatoj që zoti Adem Hoxha u propozua nga Jedinstvena Goranska Partije për kandidat të Komisionit Verifikues.

Dhe në fund ftoj Partinë Rome të Bashkuar të Kosovës që ta propozojë kandidatin e tyre për Komisionin Verifikues.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Përshëndetje për të gjithë kolegët deputetë!

E shfrytëzoj rastin që sinqerisht t'ju uroj mandatin e ri dhe t'ju dëshiroj suksese!

Pasi edhe unë jam i vetmi nga Partia Rome e Bashkuar e Kosovës dhe komuniteti rom, e propozoj veten time, Albert Kinolli. Faleminderit!

KRYESUESI: Meqë arritëm propozimin e tërësishëm të kandidatëve për Komisionin Verifikues, dhe për të cilët me radhë bëra konstatimet përkatëse, atëherë është momenti që ta votojmë këtë listë. Por, para atij momenti është e domosdoshme që ta konstatojmë numrin e mjaftueshëm dhe të domosdoshëm për të proceduar në mënyrë normale praninë e kuorumit.

Miku im, ish-studenti im, më tregon që në sallë janë 111 deputetë, kështu që është numër magjik, pra numër i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për të proceduar në mënyrë legjitime procedurën e votimit.

Meqenëse elektronika nuk funksionon, atëherë kam dëshirë që të konstatojmë që votimin do ta bëjmë në mënyrë konvencionale me ngritje dore. Prandaj të përgatitemi.

I lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për emërimin e anëtareve të Komisionit të Përkohshëm.

Do t'i bëj tri pyetje me radhë, të cilave do t'ju përgjigjeni me ngritje dore.

Kush është për Komisionin e përmendur?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Atëherë me 111 për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, konstatoj se Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimi e Kuorumit dhe Mandateve të Deputetëve.

E ftoj Komisionin e posaçëmëruar që të mblihet në sallën nr. 10 të së njëjtës ndërtesë për ta kryer punën e tyre.

Meqë s'kemi ç'të bëjmë, propozoj pak relaksim dhe një pauzë 15-minutëshe.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYESUESI: Kolegë deputetë,

Me respekt të veçantë desha t'ju lutem, të ulemi të gjithë e të fillojmë punën.

Si duket, jemi të gatshëm të procedojmë, ftoj kryesuesen e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandateve, deputeten Albulena Haxhiu, që ta prezantojë raportin.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i themeluar me vendim të seancës konstituive më 26 dhjetor 2019, në përputhje me mandatin e tij Kuvendit ia paraqet këtë:

R a p o r t

Në mbështetje të nenit 9.4 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, në mbledhjen e mbajtur më 26. 12. 2019 e shqyrtoi dokumentacionin përkatës zgjedhor, si vijon:

1. Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nr. 1845/2019, datë 27. 11. 2019, për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 6 tetor 2019, së bashku me listën përfundimtare të kandidatëve.

Komisioni në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të cekur më lart konstaton:

1. Në Legjislaturën VII për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë certifikuar 120 deputetë nga partitë politike, koalicionet, iniciativa qytetare që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019, si vijon:

Lëvizja Vetëvendosje me 29 deputetë; Lidhja Demokratike e Kosovës, 28 deputetë; Partia Demokratike e Kosovës, 24 deputetë; AAK-PSD-koalicioni “100% Kosovë”, 13 deputetë; Lista serbe, 10 deputetë; Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re, Partia e Drejtësisë, 6 deputetë; Koalicioni Vakrat, 2 deputetë; Kosova Demokratik Turk Partisi, 2 deputetë; Partia Liberale Egjiptiane, 1 deputet; Nova Demokratska Stranka, 1 deputet; Partia e Ashkalinjve për Integrim, 1 deputet; Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, 1 deputet; Jedinstvena Goranska Partija, 1 deputet; dhe Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, 1 deputet.

Komisioni ka konstatuar se në seancën e sotme janë të pranishëm 111 deputetë dhe mungojnë: Uran Ismajli, Abelard Tahiri, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Fatmir Limaj, Enver Hoxhaj, Behgjet Pacolli, Endrit Shala, Kujtim Gashi, të cilët në seancën e radhës duhet ta japin betimin. Andaj, seanca konstituive mund t'i vazhdojë punimet sipas agjendës së paraparë dhe rregullave të procedurës.

Në emër të Komisionit, ju falënderoj.

KRYESUESI: E falënderoj deputeten Albulena Haxhiu për raportin që e paraqiti mjaft elegant, përmbajtjesor dhe me përmbajtje legjitime. Tani është momenti që të votojmë raportin e paraqitur, por para atij momenti është e domosdoshme që të konstatojmë se është kuorumi në sallë i pranishëm apo jo.

Informohem momentalisht që në sallë gjenden 110 deputetë, prandaj është numër i mjaftueshëm që të konstatojmë prezencën e forumit. Ndaj dhe janë të plotësuara rregullat legjitime që ne të procedojmë me votimin. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për raportin e pyetjeve përkatëse.

Kush është për raportin?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Ju faleminderit!

Me 110 vota për, me zero vota kundër dhe zero vota abstenim konstatoj që Kuvendi miratoi Raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Forumit dhe Mandateve të Deputetëve të Legjislaturës së Shtatë.

Zonja dhe zotërinj,

Këtu edhe përfundoi pika e parë e rendit të ditës, në mënyrë, shpresoj, të suksesshme dhe më lejoni që tani të kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Dhënia e betimit të deputetëve

Dhënia e betimit të deputetëve është sa procedurale, aq edhe kushtetutare. Konsiston në këtë procedurë: ne do të ngrihemi në këmbë, unë do të lexoj tekstin e betimit dhe pastaj në fund të leximit, ju do të shqiptoni fjalën "Betohem".

Atëherë, ju lus që të ngrihemi në këmbë dhe të dëgjoni tekstin e betimit:

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder dhe përkushtim do ta kryej detyrën time, do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe respektimin e kushtetutshmërisë, të ligjshmërisë për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe standardet evropiane. Betohem!”

(“Betohem” nga salla)

Ju faleminderit!

Lus kolegët deputetë të nderuar, që ta nënshkruani deklaratën, e cila gjendet në tavolinë para jush.

Para se të përfundoj këtë pikë të rendit të ditës, kam dëshirë që të jap një informacion që deputetët, të cilët mungojnë sot në këtë seancë, kanë rastin që sipas nenit 10, paragrafit 2 të bëjnë betimin në mbledhjen suksesive të parë. Ju faleminderit!

Duke konstatuar që pika 2 e rendit të ditës u krye, më lejoni të kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mbështetur në nenin 67, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar, ndaj edhe në bazë të nenit 67, paragrafit 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Grupi Parlamentar me numër më të madh të deputetëve i dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019 është Lëvizja Vetëvendosje dhe e ka të drejtën për të propozuar kandidatin për kryetar të Kuvendit. Ju njoftoj që kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, pra minimumi është 61 vota për.

Duke mos ju vonuar, e ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje që ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Fjalën e ka kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Propozimi ynë për kryetar të Kuvendit të Republikës është deputeti Glauk Konjufca.

KRYESUESI: Konstatohet që propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje është që për kryetar të Kuvendit të Kosovës të jetë Glauk Konjufca. Natyrisht, para çdo votimi, kam dëshirë të konstatohet numri i deputetëve të pranishëm në sallë, pra edhe rregullat e legjitimitetit për të proceduar me votimin.

Konstatohet që të pranishëm janë 111 deputetë. Pra, numri i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm që në mënyrë legjitime të procedohet me votimin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës. Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për kandidatin e propozuar, deputetin Glauk Konjufca.

Ju lutem, mbani më gjatë dorën!

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Më lejoni ta konstatohet rezultatin e votimit:

Për janë 75 vota, kundër 27 vota dhe abstenim 6 vota.

Në bazë të rregullave, nenit të 67, paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës konstatohet që për kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës në mënyrë të suksesshme zgjidhet deputeti Glauk Konjufca.

Tani procedojmë me zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit. Në bazë të nenit 67, paragrafit 3 dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, tri grupet më të mëdha parlamentare të dala nga zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019, propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në mënyrë kumulative votohet për të tre kandidatët. Ndaj do të kërkoj me radhë që të gjitha tri partitë e para ta propozojnë kandidatin e tyre.

E ftoj përfaqësuesin e Lëvizjes Vetëvendosje që ta propozojë kandidatin për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Lëvizja Vetëvendosje për nënkryetar të parë të Kuvendit të Republikës së Kosovës propozon deputeten, zonjën Arbërie Nagavci.

KRYESUESI: Më lejoni të konstatohet që deputetja Arbërie Nagavci kandidohet për nënkryetare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

E ftoj Lidhjen Demokratike të Kosovës që ta propozojë kandidatin për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Në emër të grupit tonë parlamentar, propozojmë akademik Kujtim Shalën për nënkryetar të Kuvendit! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Konstatoj që dr. Kujtim Shala, kandidohet për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ftoj përfaqësuesin e Partisë Demokratike që ta propozojë kandidatin për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

BEDRI HAMZA: Partia Demokratike e Kosovës propozon deputetin Memli Krasniqi për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Zoti Memli Krasniqi është kandidati i propozuar për nënkryetar nga ana e Partisë Demokratike të Kosovës.

Pra, edhe një herë konstatoj që kandidatët e propozuar, tre kandidatët e propozuar për nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë: zonja Arbërie Nagavci, zoti Kujtim Shala dhe zoti Memli Krasniqi.

Para se të votojmë, kam dëshirë që të konstatoj ekzistencën e kuorunit.

Me kënaqësi konstatoj se marrin pjesë 111 deputetë dhe ekziston kuorumi. Prandaj, ekzistojnë kushtet legjitime për të proceduar me votimin.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për të tre kandidatët e propozuar për nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kush është për? Pra, jemi duke votuar. Ata që janë për, le ta ngrenë dorën për kandidatët e përmendur për nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Natyrisht, kjo procedura me aklamacion krijon ngatërresa, edhe logjike. Megjithatë, shpresojmë që në të ardhmen do ta kemi në dispozicion elektronikën.

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Kolegë deputetë,

Më lejoni të konstatoj që votimi është kryer në mënyrë të suksesshme.

Me 104 vota për, 1 votë kundër dhe 3 abstenime, konstatoj që zonja Arbërie Nagavci, Kujtim Shala dhe Memli Krasniqi zgjidhen nënkryetarë të Kuvendit të Kosovës.

Tani vazhdojmë me zgjedhjen e dy nënkryetarëve të Kuvendit, 1 nga radhët e deputetëve të komunitetit serb dhe 1 nga radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera joshumicë. Zgjedhja e tyre do të bëhet në mënyrë komulative, pra me një votim të përbashkët.

Mbështetur në nenin 67, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, deputetët që mbajnë vende të garantuar për komunitetin serb propozojnë 1 deputet për nënkryetar të Kuvendit dhe 1 deputet për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, po ashtu propozojnë një kandidat.

E ftoj përfaqësuesin e deputetëve të komunitet serb që ta propozojë kandidatin e tyre për nënkryetar të Kuvendit.

IGOR SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

U ime Srpske liste i Srpske zajednice za potpredsednika kandidujemo gospodina Slavka Simića. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatojmë që Slavko Simiq është deputeti i propozuar për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

I ftoj përfaqësuesit e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë të propozojnë kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

ADEM HODŽA: Hvala gospodine predsedavajući!

Poslanici nevećinske nerspske Zajednice za kandidata potpredsednika Skupštine Kosova predlažemo gospodina Fikrim Damka.

KRYESUESI: Jemi të njoftuar që nga një grup të deputetëve, nga 7 deputetë, kemi marrë emrin në fjalë, por sidoqoftë, edhe propozim e dëgjuam që Fikrim Damka të jetë kandidat për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Andaj, kemi dy propozime, pra dy emra të respektuar: Slavko Simiq dhe Fikrim Damka.

Para se të shkojmë në votim është mirë të konstatojmë a kemi kuorum. Prezentë janë 111 deputetë. Pra, konstatojmë që ekzistojnë kushtet legjitime për të proceduar me votim.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për dy kandidatët e propozuar për nënkryetarë të Kuvendit të Kosovës.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Më lejoni të konstatoj që votimi është kryer në mënyrë të suksesshme:

92 vota janë për, 2 vota janë kundër dhe 2 abstenime.

Konstatoj që Slavko Simiq dhe Fikrim Damka zgjidhen në mënyrë të suksesshme për nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Siç duket, puna jonë është kryer, votimet u kryen në mënyrë të suksesshme. E ftoj kryetarin e porsazgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta zërë vendin e tij.

Faleminderit për durimin!

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Kujtim Shala,

Të dashur dhe shumë të nderuar kolegë deputetë,

Ne, qysh në fillim duam t'ju falënderojmë që e themeluat Legjislaturën VII të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ju falënderoj që na e besuat këtë detyrë të rëndësishme dhe e cila është me shumë përgjegjësi.

Ne ju garantojmë që si Kryesi e Kuvendit të Republikës së Kosovës do t'i kryejmë detyrat tona ashtu siç kërkohet, me shumë nder, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe sipas Kushtetutës sonë, e cila është në fuqi.

E falënderojmë po ashtu edhe korin diplomatik, ambasadorët e pranishëm në këtë seancë themeluese të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të gjithë mysafirët, të cilët na kanë nderuar me praninë e tyre në këtë seancë konstituive.

Po ashtu, desha t'i falënderoj edhe mediat, edhe gazetarët e shumtë, të cilët po i shoh atje, dhe të cilët së bashku i falënderojmë që e kanë përcjellë këtë seancë themeluese të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Por, mbi të gjitha unë po i bashkëngjitem urimit tuaj si deputetë të Republikës së Kosovës, për ata që janë më të rëndësishmit: për qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse pa besimin e tyre nuk do të ishim as ne këtu ku jemi, në këto ulëse të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Andaj, i falënderojmë ata që na e kanë dhënë këtë mundësi për t'i kryer detyrat që i kemi marrë.

Të nderuar deputetë,

Me këtë i mbyll punimet e seancës konstituive të Legjislaturës VII të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Mirupafshim në seancën e radhës, të cilën sapo ta caktojmë, do të njoftoheni me kohë dhe ashtu siç duhet. Faleminderit!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë